32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kérkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkoen më për përdorim përkizati me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkoen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e konratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e konratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Konratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Konratës.

37.2 Shkelja themelore e konratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyё të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e konratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të konratës për arsyё të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijoen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të konratës, Menaxheri I Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet t'i paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38**Forca madhore**

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me konratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të konratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e konratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së konratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të konratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të lëshoi një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara , siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të konratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkoħshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet pér shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet pérmbushja e kontratës nga shpérthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet pér punët e kryera para pranimit të tij dhe pér punët e kryera më pas pér të cilat është arritur mosmarrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet pér të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim pér pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe pér ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh tē dobishme, palët do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do tē i përgjigjet kérkesës pér zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha maksimale që jepet pér arritjen e kësaj zgjidhjeje do tē jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja pér tē arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon tē përgjigjet me kohë ndaj kérkesave pér zgjidhje, tē dyja palët do tē jenë tē lira tē vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore tē mosmarrëveshjes dështon, palët mund tē merren vesh tē përpilen tē pajtohen përmes institucionit tē specifikuar në KVK. Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit tē procedurës së pajtimit, secila palë do tē ketë tē drejtë tē vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kérkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin pér mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	i 2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	e 10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vleres se kontrates , për kohëzgjatjen e periudhës prej 9 muaj
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	i 11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dërmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkësave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dërmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dërmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me

		<p>Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit te kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 8 muaj
Dëmet likuiduara e	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës
Parimet përgjithshme të pagesave	24	<p>Pagesat do te behën ne situacione.</p> <p>Situacionete paguhen ne vleren prej 30 000,00€ , e me teper me konstatim nga menaxheri i kontrates dhe organi mbikqyres .</p>

Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës.</p> <p>Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.</p> <p>Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkësë".</p> <p>Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve për 2 vite .</p>
Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA RENOVIMI I SH.M."GJIN GAZULLI" - S+P+2E PRISHTINË-

VEREJTJE: Materialet e propozuara në përhshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren, përfshirë gjitha pozicjonet dhe përfshirë gjitha fazat, andaj të gjitha ato mund të zvërvendoshen me materiale të prodhueseve tjerë me karakteristika të njëjtë ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikata apo atestet e ofruara nga prodhuesit respективisht.

A	PUNËT NDËRTIMORE	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi(€)	Totali (€)
1 PUNËT PARAPERGATITORE					
Poz.	Përhshkrimi teknik				
1.1	Rrethimi dhe sigurimi i pjesës së paraparë për renovimin e objektit me llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtës dhe shenjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilët e hekurit dhe llamarina. Ne cmim te kalkulohen edhe shenjet lajemruese per mbrojtjen e shendetit dhe sigurin ne pune. Kujdes te vecant duhet kushtuar pershyjeve kryesore te objektit dhe per gjata rruget kryesore.	m ²	146.00	1.0 €	146.00 €
1.2	Organizimi i punishtës dhe depove, furnizimi me material per ndërtimi i rjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rjetit elektrik dhe ndriçimit të kantieri, vendoja e kontejnerit përfshirë zyren e menaxhimit të projektit.	m ³	1,330.29	0.30 €	399.09 €
1.3	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntoksore , zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ te ndërtimit dhe renovimit si dhe perpilimi i planit detali operativ që lidhet me procesin e ndërtimit . Ne cmim te logaritet edhe kosti eventuale e detektimit me separatur elektroteknike per instalime nentoksore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet te mirembahen gjate kohes se ndërtimit (rjeti elektrik , rjeti i ujësjellësit, kanalizimi etj.)	m ²	5,114.50	0.20 €	1,022.90 €
1.4	Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e përkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastimi i objektit si dhe tereni mëth objektit.	komplet	1.00	100.00 €	100.00 €
TOTAL 1.					1,666.99 €
2 PUNËT E DEMOLIMIT					
Poz.	Përhshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi(€)	Totali (€)
	Vërejtje: Të gjitha materialet e demoluara inerte dhe të papërdoruhme duhet të transportohen deri në deponinë e përrëaktuar nga autoritetet kontraktues dhe organi mbikqyrës.				
2.1	Demolimi i mbulesës nga llamarina me të gjitha profilët dhe elementet vertikale dhe horizontale konstruktive metalik, në strehën e hyrjes kryesore.	m ²	40.00	0.10 €	4.00 €
2.2	Demolimi, preraja precise e strehës nga B.A dhe mbulesës nga llamarina me të gjitha profilët dhe elementet vertikale dhe horizontale konstruktive, në strehën e hyrjes se suterenit.	m ³	17.00	1.00 €	17.00 €
2.3	Demolimi i mbulesës së kulmit te pjerret me të gjitha elementet përcjelise: tjegullat, listelat, kontralistelet si dhe drresimi i kulmit. Llogaria ne m ²	m ²	1,400.97	0.50 €	700.49 €
2.4	Demolimi i konstrukcionit të kulmit te pjerret me të gjitha elementet përcjelise konstruktive mbajtëse. Llogaritja përmëtë bazës	m ²	1,400.97	0.10 €	140.10 €
2.5	Demolimi i mureve ndarje te brendshme te nyjeve sanitare nga materiali i argjipes d=20cm. Demolimi i mureve te realizohet sipas projektit, dhe te kalkullohet per m ²	m ²	185.60	0.50 €	92.80 €
2.6	Demolimi i plakave te qeramikes ne nyjet sanitare te objektit dhe të palestreve sportive, gryerja të realizohet deri në plakën e B.A.	m ²	60.25	0.10 €	6.03 €
2.7	Demolimi i dyshemesë nga materiali teracer, ne hapësirat e koridoreve, shkallat dhe hapësirat tjera. Demolimi te realizohet deri në plakën e betonit. Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	658.60	0.10 €	65.86 €
2.8	Demolimi i dyshemesë nga materiali, laminat ne hapësirat e klasave kabinetive, laboratoreve, amfiteatrit Ne cmim te realizohet edhe demolimi i parket ne hapësiren e palestreve. Demolimi te realizohet deri në plakën e betonit.Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	658.25	0.30 €	197.48 €
2.9	Demolimi i tepisonit ne binen e amfiteatrit Ne cmim te realizohet edhe demolimi i perdeve me të gjitha elementet përcjelise. Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	34.20	0.20 €	6.84 €
2.10	Demolimi i dyshemesë së sellës së sportit. Pozicioni përfshinë të gjitha shpresat ekzistuese deri në nivelin e plakës beton arme.Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	382.00	5.00 €	1,910.00 €




2.11	Demolimi i plakave te shkallët e hyjes kryesore, dhe hyrje ne suteren. Demolimi te realizohet deri ne plakën e betonit.Ne cmim te logaritet edhe demolimi i plakave te shkallët e jashtme te ciat kan qasje te fusha sportive. Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	126.50	1.00 €	126.50 €
2.12	Demolimi i plafonit të varur (amstrog dhe nga plakat e knauff) me të gjitha elementet e montuar duke përfshirë edhe trupat ndryshues. Demolimi te realizohet deri në plakën e betonit.Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ²	m ²	1,485.20	0.10 €	146.52 €
2.13	Demolimi (gryerja) e suvatimit ne të gjitha muret e brendshem te objektit deri ne tuta. Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ² . Në cmim te logaritet edhe demolimi i instalimeve të ndryshme të improvizuara dhe të shtuara mbi dhe nën sipërfaqet e mureve(prizat,kablot, ndërprerësat, llampat,etj.).	m ²	3,150.20	1.00 €	3,150.20 €
2.14	Demolimi (gryerja) i plakave të qeramikes në të gjitha muret e brendshem deri te bloku i argjiles. Siperfaqja demoluse te logaritet ne m ² . Në cmim te logaritet edhe demolimi i instalimeve të ndryshme të improvizuara dhe të shtuara mbi dhe nën sipërfaqet e mureve(prizat,kablot, ndërprerësat, llampat,etj.)	m ²	254.82	0.10 €	25.48 €
2.15	Demolimi i deres se hyrjes kryesore nga materiali i drurit me dimensione 260x180.	copë	1.00	1.00 €	1.00 €
2.16	Demolimi i dyerive se hyrje kryesore te suterenit nga materiali i drurit me dimensione 260x300.	copë	4.00	1.00 €	4.00 €
2.17	Demolimi i dyerive nga materiali i pvc me komiza nga metall me dimensione 200x90.	copë	31.00	1.00 €	31.00 €
2.18	Demolimi i dyerive nga materiali i plastikes me dimensione 200x80.	copë	14.00	1.00 €	14.00 €
2.19	Demolimi i dyerive nga materiali i plastikes me dimensione 260x180.	copë	7.00	1.00 €	7.00 €
2.20	Demolimi i dyerive nga materiali i plastikes me dimensione 260x90.	copë	1.00	1.00 €	1.00 €
2.21	Demolimi i dyerive nga materiali i plastikes me dimensione 260x160.	copë	2.00	1.00 €	2.00 €
2.22	Demolimi i dyerive nga materiali i plastikes me dimensione 210x160.	copë	1.00	1.00 €	1.00 €
2.23	Demolimi i deres se kalcajes nga materiali i metait me dimensione 200x180.	copë	1.00	1.00 €	1.00 €
2.24	Demolimi i gardhit te shkalleve kryesore nga metall.	m'	45.00	0.20 €	9.00 €
2.25	Demolimi i gardhit te shkalleve nga materiali i argjiles.	m'	30.00	1.00 €	30.00 €
2.26	Demolimi komplet i rrethojës metalike së terranit të jashëm sportiv.	m ²	864.20	0.10 €	86.42 €
2.27	Demolimi i kujdeshëm i sistemit të monitorimit dhe alarmit kundër zjamt duke përafshirë kamerat e sigurisë, monitorët, instalimin e tèresishëm dhe pjesat tjera në lidhje me të.	komplet	1.00	5.00 €	5.00 €
2.28	Prerja precise e plakës se betonit për hapjen e vrimave ne secilin kat, dhe ne secilin pjesë ku parashihet vendosja e vertikaleve te kanaлизimit me dimensionet 25x25 cm .	copë	52.00	1.00 €	52.00 €
2.29	Demontimi i kubzave të betonit ku kaon gypi i kanalizimit. Ne cmim të logaritet komplet shtresa e zhavoriturte njësje si dhe montimi i kubzave ne gjendjen e mëparshme(në rast se demtohen kubëzat shpenzimet i bart punëkryesi) Cmim per sip. te kubzave	m ²	1,517.00	0.10 €	151.70 €
2.30	Demolimi (prerja e asfaltit te pjesë e fushës sportive) . Ku do te punohet rrjeti i kanalizimi me gjersë1m	m ²	420.00	0.10 €	42.00 €
2.31	Demolimi kompleti i rjetit te kanalizimit te brendshme dhe sistemit të ujt ekzistues, me gypa nga azbesi dhe pvc, Ø160, Ø125, Ø110, Ø75. Ne hapsirat e brendshema te objektit, me të gjitha pjesat tjera fazonike.	m ²	285.70	0.10 €	28.57 €
2.32	Demolimi i ollukave ekzistuese horizontale dhe vertikale ne objektin shkollor.	m ²	320.00	0.10 €	32.00 €
2.33	Demolimi i pikoreve nga llamarina ne pjesen e jashtem te seciles dritarë .	m ²	229.65	0.10 €	22.97 €

TOTAL 2. 7,112.84 €

3. RREGULLIMI I PARTERIT					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Basisa	Çmimi për njësitë (€)	Totali (€)
3.1	Pastrimi i terenit, prerja e drunjave te ciat nuk kan vler dhe te ciat janë te deriuara, prerja e cungave te ndryshëm, shkurreve te vjetra si dhe pastrimi i lokacionit per krijimin e hapësirave te reja gjelberuese. Logaria ne m ² Vërejje: Asnjë dru nuk lejohet të prehet pa pëloqimin e drejtorisë përkatëse komunale	m ²	2,665.00	0.10 €	266.50 €



3.2	Gërmimi i humusit në thellësi prej 30 cm, gërmimi duhet të bëhet rrëth perimetri të objektit në gjersë 1m. Dhe ahtegut të ri te ecjes dhe furnizimit të kalldaja. Dheu të transportohet deri në deponi e percaktuar nga organi mbikqyrës.	m ²	653.10	0.20 €	130.62 €
3.3	Rrafshimi dhe nivelzimi së sipërfaqes së partent me zakësi deri në ±2 cm, duke krijuar pjesësin e nevojsime terthore per kujimin e ujave sipërfaqesore, ngjeshja me cilindër vibrues deri në amitjen e kompaktesisë prej $M_s=30$ Mpa.	m ²	1,517.20	0.30 €	455.16 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me fraksion 0-63 mm me trashesi $t=30$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s=40$ Mpa)	m ³	524.20	5.00 €	2,621.00 €
3.5	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me fraksion 0-31.5 mm me trashesi $t=10$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s=60$ Mpa)	m ³	334.60	4.00 €	1,338.40 €
3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve me dimensione 8/20 cm per kufizimin e platos , ne qimim te llogarijet betoni per shtangimin e skajoreve	m'	678.20	4.00 €	2,712.80 €
3.7	Furnizimi, transporti, vendosja e kubzave me dimensione 20x10x6 cm me ngjyre te hirti , ne qimim te kalkulohet shpresë e raves fraksion 4 mm me trashesi $t=5$ cm dhe mbushja e fugave te kubzave me rreth te imet. Llogariaj ne metër katrorë.	m ²	1,517.20	7.00 €	10,620.40 €
3.8	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Panja ("Acer platanoides "Globosum"), me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm,sistem mënjer mirë i zhvilluar, i përcjelur me dhe, dhe i certifikuar. Mbillet duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dha natyral (marr nga shpresë e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidiqe deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të janë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	copë	30.00	5.00 €	150.00 €
3.9	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Ginko ("Ginkgo biloba"), Dru dekorativ gjethet e verda ne vjeshtë, me lartesi 250cm mbi nivelin e dheut, rezistencë ndaj tokave jo shume pjellore, tolerant ndaj ndotjes urbane. Mbillet duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dha natyral (marr nga shpresë e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidiqe deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të janë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	copë	20.00	5.00 €	100.00 €
3.10	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e OPATIJA- përzijeje e barit për sipërfaqet me diell, i certifikuar. Mbillet ne thellësi 0.5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojsime për 1 m ² është 20-25 g. Pas mbjetjes bëhet ngjeshja me cilindra 30-50 kg të rënë dhe ujija me kujdes të shtruar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, tekture 10 mmët dhe pH neutrale (dobët acidiqe deri dobët bazike), e të cilës duhet shtruar edhe 2-3 kg m ² treset dhe 15-20 g/m ² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të sillet dhe që i përbushit këtij karakteristika në shpresë 15-20 cm. Bimët nuk guxojnë të janë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	m ²	2,665.00	0.20 €	533.00 €



4 PUNËT E MURATUMIT					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi(€)	Totali (€)
4.1	Fumizimi me material si dhe montimi i mureve ndarëse për toalete dhe dushe me HPL panela (High pressure laminate) me trashesi 10mm sipas standardeve evropiane të rezistencës së ndaj largështisë, në çmim duhet të përfshihen edhe dyert sipes detaleve të dhëna me arkitektur, dhe të gjitha elementet e nevojshme siq janë mbajtëset përmes muri, mënteshat, dorëzat përmes dyer etj me material jo korodues, që ky aktivitet të jet funksional. Vërejtje: Gjatë fazës së ofertimit në tender ofertuesi është i obliguar të bashkangjes edhe katalogun përmes produsentit e përshtkuar në këtë aktivitet	m ²	61.20	15.00 €	918.00 €
TOTAL 4.					




6 PUNËT E SIVATIMIT					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njëse(€)	Total(€)
5.1	Furnizimi me material si dhe mveshja e mureve me plaka gipsi te pasuruara me fibra druri dhe fibra qelqi sistemi "INDOOR" për perdonim të mbrendshëm sipas standartit SR EN 520 -A1 Vërejje: Gjatë fazës së ofertimit në tender ofertuesi është i obliguar të bashkangjes edhe katalogun për produktin e përshtkuar në këtë aktivitet	m ²	3,150.20	22.00 €	69,304.40 €
5.2	Furnizimi dhe ekzekutimi i gledit te të gjitha mureve e brandshme dhe tavanit duke mos llogaritur muret e nyjeve sanitare. Gledi te realizohet me dy shtresa, paraprakishtë të bëhet pergadjitja me lenden bazë, sipërfaqja duhet te jetë e lemuar dhe getshme per ngjyras.	m ²	4,133.00	1.00 €	4,133.00 €
TOTAL 5.					73,437.40 €
6 PUNËT E FASADES					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njëse(€)	Total(€)
6.1	Furnizimi dhe ekzekutimi i fasadës termike demit (ne llogari te muret styrduroj 10 cm, rjetë rabiq, laq i plastifikuar dhe ngjyra) në nuancë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit. Fasada te realizohet ne murtë e suterët.	m ²	265.80	18.00 €	4,784.40 €
TOTAL 6.					4,784.40 €
7 PUNËT E NGJYROSJESE					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njëse(€)	Total(€)
7.1	Furnizimi, transporti dhe ngjyrasja e mureve, te brandshme, dhe tavanit khinave mbi bazament të gjetuar. Me ngjyre akritike ne dy shtresa me nuancë të bardhë.	m ²	4,133.00	2.00 €	8,266.00 €
7.2	Furnizimi, transporti dhe ngjyrasja e fasades se jashtme. Me ngjyre arklike ne dy shtresa me nuancë të hirtë.	m ²	1,845.20	2.00 €	3,690.40 €
TOTAL 7.					11,556.40 €
8 PUNËT E NIVELIZIMIT DHE HIDROIZOLIMIT					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njëse(€)	Total(€)
8.1	Furnizimi dhe vendosja e materialet termoizolues me trashesi t=4.0 cm 2x2 e cilë vendoset mbi plakën B.A. Në çmim të llogaritet edhe shtresa mbrojtëse e termoizolimit folja plastike.	m ²	1,746.00	4.00 €	6,984.00 €
8.2	Furnizimi i materialet dha punimi i shtreses se estrihit, me makinë me trashësi 5-7cm mbi bezën e përgatitur të shtresave izoluese stiroborit t=4cm	m ²	1,746.00	4.50 €	7,857.00 €
8.3	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare ne të gjithë objektin dhe salles së sportit, duke përfshirë hidroizolimin e mureve deri në 30 cm lartësi me hidroizolim të lëngshëm fiksibl dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex në dy shtresa me trashësi nga 1 mm. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plesarijën e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike të përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	832.70	1.00 €	832.70 €
8.4	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i murëve ne suteren. Hidroizolimi te realizohet ne muret periferik te cilat kan kontekte me dheun. Me hidroizolim të lëngshëm fiksibl dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex në dy shtresa me trashësi nga 1 mm. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plesarijën e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike të përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	694.20	1.00 €	694.20 €
TOTAL 8.					16,367.90 €
9 PUNËT E GRANITIT DHE QERAMIKËS					
Poz.	Përshkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njëse(€)	Total(€)




9.1	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve te brendshme trikrashëshe dhe shkallëve dykrashëshe, pushimoreve dhe perimetrin me plaka graniti natyral me sipërfaqe të vrazhdëtë flakëruar. Ngjithë të bëhet me llaç të cimentos me trashësi min.2cm Ngjyra dhe tekstura e plakave të granitit përcaktohet nga organi mbikqyrës. Plakat e shkallësve e shkallëve të jenë me gjerësi 35 cm dhe trashësi 3 cm, ndërsa balloret dhe pushimoret realizohen me trashësi 2 cm. Vërejtje: Plakat në anët e lira duhet të dalin jashë sipërfaqes vertikale për 3 cm.	m ²	172.30	55.00 €	9,475.50 €
9.2	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme me granit natyral te hyrja kyresore, hyrja ne suteren, hyrja ne pjesa e fushës sportive. Pushimoret dhe perimetrin me plaka të granitit me sipërfaqe të vrazhdëtë flakëruar. Ngjithë të bëhet me llaç të cimentos me trashësi min.2cm Ngjyra dhe tekstura e plakave të granitit përcaktohet nga organi mbikqyrës. Plakat e shkallësve e shkallëve të jenë me gjerësi 35 cm dhe trashësi 3 cm, ndërsa balloret dhe pushimoret realizohen me trashësi 2 cm. Vërejtje: Plakat në anët e lira duhet të dalin jashë sipërfaqes vertikale për 3 cm.	m ²	30.40	60.00 €	1,824.00 €
9.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i solobanakave me plaka graniti t=2cm Ngjithë të bëhet me llaç të cimentos me trashësi min.2 cm Ngjyra dhe tekstura e granitit të përcaktohet nga organi mbikqyrës. Vërejtje: Plakat në anët e lira duhet të dalin jashë sipërfaqes vertikale te murit për 3 cm.	m	462.50	10.00 €	4,625.00 €
9.4	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së nyjeve sanitare. Me plaka të paglazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë të përcaktuar nga organi mbikqyrës. Plakat duhet të jenë rezistente ndaj rëshqitjes të klasic min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngërçave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuencën të madhe me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijuimit të njolave. Ngjithë e plakave të bëhet me ngjithës kualitativ fleksibili dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellet këndore nga aluminji si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitari rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	80.25	15.00 €	1,203.75 €
9.5	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve të nyjeve sanitare deri në lartësinë 250 cm, me plaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë të përcaktuara nga organi mbikqyrës. Plakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngërçave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijuimit të njolave. Ngjithë e plakave të bëhet me ngjithës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellet këndore nga aluminji si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitari rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	254.20	15.00 €	3,813.00 €
9.6	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemes(kaçdaja dhe koridori teknik). Me plakat e keramikës te kualitetit te lartë. Dizajni sipas investitorit	m ²	42.00	15.00 €	630.00 €

TOTAL: 21,872.25 €




PUNËT E DYSHEMESE					
Poz.	Përkrahimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
10.1	Fumizimi dhe vendosja e dyshemesë me PVC HETEROGEN t=3.2mm ne hapesirat e kalsave,kabineteve zyreve administrative,laboratoreve,zhveshorët hapesires per rekreacion,depot etj.(në rohe) lidhja bëhet me ngjites adekuat, në logari të merret shtresa vetylivilizuese, ngjitesi adekuat, diktuni dhe shirri i rreth perimetrit të mureve në lartesi h=8 cm	m ²	1,015.60	28.00 €	28,438.80 €
10.2	Fumizimi dhe vendosja e dyshemesë me PVC HETEROGEN t=6.0mm ne hapesirat sellës së sportit (në rohe) lidhja bëhet me ngjitesi adekuat, në logari të merret shtresa vetylivilizuese, ngjitesi adekuat, diktuni dhe shirri i rreth perimetrit të mureve në lartesi h=8 cm	m ²	382.00	40.00 €	15,280.00 €
10.3	Fumizimi me material dhe investitura e dyshemesë së amfiteatrit me laminat adekuat per hapësira publike si laminati i prodhuesit KRONO - nga seria Floordreams Vano, tipi Aquastop 10 mm me klimik i ashtuquajtur "1click2go" me rënështresën adekuate zëabsorbuese nga PE me trashësi 5 mm. Laminati duhet të ketë shiresën finale joustëshuese, antibakteriale dhe rezistente ndaj mikro-gërvishjeve, me klasë R9 kundër mëshqijes dhe i takon klasi "Class 33 / AC 5" i destinuar për shfrytëzim intensiv në objekte komerciale. Tehet i laminatit të thyera në formë të shkrinjës "V". Në çmim duhet të përfshihen elementet përcjellëse si rozeta/unazat nga druri për tubat që departojnë dyshemenë, listjet e cokilës nga druri si tipi K70 me dimensione 21x70 mm ndërsa për fugat e dilatimit dhe për kapërcimin e fugave dhe disniveleve duhet të përdoren profili adekuate nga aluminji. Ngjyra, tekstura dhe shkalla e shkëqiqimit të laminatit të përzgjidhet nga organi mbikqyrës.	m ²	137.60	13.00 €	1,788.80 €
